



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.73/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 29.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.73/2025, e datës 28.09.2025, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 28.09.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se më datë 27.09.2025, kandidatja për Kryetare të Drenasit, Egzona Tërdevci, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", në rrjetin social Facebook, në profilin e saj ka postuar një shkrim se PDK ka dy kandidatë në garë për kryetar të Drenasit, duke aluduar në z. Petrit Hajdari dhe z. Ramiz Lladrovci. Ky deklaram publik i znj. Tërdevci përbën keqpërdorim të emrit dhe identitetit politik të PDK-së, me qëllim mashtrimin dhe keqinformimin e elektoratit, si dhe krijimin e një perceptimi të rremë për Partinë Demokratike të Kosovës. Sjellja e përshkruar më sipër e znj. Tërdevci përbën dezinformim të drejtpërdrejtë të elektoratit dhe, për më tepër, dëmton integritetin e procesit zgjedhor përmes keqpërdorimit të emrit, historisë dhe identitetit të një subjekti politik tjetër, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Kjo sjellje përbën shkelje serioze të parimeve të garës së ndershme dhe të informimit të saktë të votuesve. Si rrjedhojë, është cenuar parimi i "zgjedhjeve të mirë-informuara" ashtu siç përcaktohet në nenin 32 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Tutje ka shtuar se kur një kandidat përdor emrin dhe reputacionin e një partie tjetër për të ndërtuar përkrahjen elektorale, pa pasur përkrahje formale nga ajo parti, ai e shkel barazinë në garë dhe e vendos veten në një pozitë të padrejtë përballë

kandidatëve të tjerë, veçanërisht përfaqësuesin zyrtar të PDK-së. Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejte të parimit të zgjedhjeve të drejta, të cilat neni 32 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme i konsideron themelore për legjitimitetin e procesit zgjedhor.

Si provë ka bashkëngjitur fotografinë e postimit nga llogaria sociale Facebook e kandidates për kryetare të Komunës së Drenasit, Egzona Tërdevci.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka deklaruar se, kandidatja për kryetare të Komunës së Drenasit, Egzona Tërdevci, ka publikuar në profilin e saj në rrjetin social Facebook një postim me karakter politik dhe satirik, në kuadër të fushatës zgjedhore. Pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë dhe nuk gjejnë mbështetje në ligj, për arsye se postimi i znj. Tërdevci nuk ka qenë mashtrues dhe as nuk ka pasur për qëllim keqinformimin e elektoratit. Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht neni 32 që përmendet në ankesë, nuk ndalon komente të kësaj natyre, por ka për qëllim garantimin e zgjedhje të lira, të ndershme dhe të mirë-informuara, pa gjuhë fyese, shpifëse apo nxitëse të urrejtjes. Në këtë rast, postimi i znj. Tërdevci nuk përmban elemente të tilla. Tutje ka shtuar se është fakt i njohur dhe i trajtuar gjerësisht në media se z. Ramiz Lladrovci nuk garon më në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, por si kandidat i një subjekti tjetër politik të certifikuar, duke u bërë i ditur gjerësisht për publikun dhe për elektoratin e Komunës së Drenasit. Për këtë arsye, çdo pretendim se postimi i znj. Tërdevci ka mashtruar apo ka mundur të mashtrojë qytetarët është i pabazuar. Duke u bazuar në të lartpërmendurat kërkojmë nga paneli që të refuzoj ankesën si të pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, konstatoi se:

-Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoj se pretendimet në ankesë se kandidatja për kryetare të Komunës së Drenasit, Egzona Tërdevci për subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, me postimin e saj në rrjetin social facebook *"Sonte nga ora 20:20 debati për Drenasin në RTK. Të sinkronizuar si në çdo veprim tjetër, edhe sot dy kandidatët e PDK-së nuk ishin prezent në këtë debat. Ju ftoj të na ndiqni!"*, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 32 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës -së, me të cilën përcaktohet se: " Kodi i Sjelljes për subjektet politike dhe mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit".

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në postimin e kandidates se LVV-së për kryetare të Komunës së Drenasit Egzona Tërdevci, sipas vlerësimit të Panelit, nuk përbën

mashtim ose keqinformim të elektoratit, si dhe nuk përbën dezinformim të drejtpërdrejtë të elektoratit dhe, për më tepër, nuk dëmton integritetin e procesit zgjedhor përmes keqpërdorimit të emrit, historisë dhe identitetit të një subjekti politik tjetër, në rastin konkret Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.73/2025 datë 29.09.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatë Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.